



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:116898
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05847251

K.Dh.Sh.II.nr.872/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen përbarimore të kreditorit Termo On Sh.P.K., me seli në Ferizaj, rr. “Driton Islami”, e përfaqëson sipas autorizimit Urim Bajraktari, avokat nga Ferizaji, kundër debitorit UNI Sh.P.K., me seli në Prishtinë, Magjistrалja Prishtinë-Gjilan, e përfaqëson sipas autorizimit Kushtrim Bytyqi, avokat nga Prishtina, me çështjen përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2263/22 të datës 08.12.2023, më datën 20.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit UNI Sh.P.K., me seli në Prishtinë, Magjistrалja Prishtinë-Gjilan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2263/22 të datës 08.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar, KPPP.nr.2263/22 të datës 08.12.2023, e ka hedhur poshtë si të pa afatshëm prapësimin të

ushtruar nga debitori UNI Sh.p.k., me seli në Prishtinë, Magjistralja Prishtinë-Gjilan, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.534/2022, të datës 19.09.2022 i lëshuar nga përmbaruesi privat Besnik H. Aliu nga Ferizaji.

Ankesë ka paraqitur debitori UNI Sh.p.k., me seli në Prishtinë, Magjistralja Prishtinë-Gjilan, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të aplikimi të gabuar të dispozitave procedural me të cilën ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit dhe të anulohet aktvendimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Termo On Sh.P.K., me seli në Ferizaj, rr. “Driton Islami”, me datën 19.09.2022 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit UNI Sh.P.K., me seli në Prishtinë, Magjistralja Prishtinë-Gjilan, në bazë të dokumentit të besueshme faturës-Nr.366 të datës 28.02.2020, për shumën e detyrimit në vlerën prej 1,000.00€, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përmbaruesi Privat Besnik H. Aliu nga Ferizaji, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.534/2022, të datës 19.09.2022, ka caktuar përmbarimin, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm- Nr.366 të datës 28.02.2020, i plotëson kushtet për përmbarim.

Ndaj këtij urdhri për lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat, ka ushtruar prapësim debitorit, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoje prapësimin si të bazuar dhe ta anulohet urdhrin për përmbarim.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke i propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të hudhet si i palejuar.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar, KPPP.nr.2263/22 të datës 08.12.2023, e ka hedhur poshtë si të pa afatshëm prapësimin të ushtruar nga debitori UNI Sh.P.K., me seli në Prishtinë, Magjistralja Prishtinë-Gjilan, i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.534/2022, të datës 19.09.2022 i lëshuar nga përmbaruesi privat Besnik H. Aliu nga Ferizaji.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar ka theksuar se gjykata e shkallës së parë pasi që ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe se prapësimi i ushtruar nga debitori në rastin konkret kundër urdhrin për përmbarim është i pasafatshëm, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me ushtrimin e prapësimi me vones rreth 2 ditë, pasi që me datën 21.09.2022 debitorit ka pranuar urdhërin përmbarimor, ndërsa ka paraqitur prapësim ndaj këto urdhërin në datën 30.09.2022, fakt ky që vërtetohet me fletëkthesën e postes që gjendet në shkresat e lëndës. Prandaj, mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë, e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka hudhë poshtë prapësimin e debitorit UNI Sh.P.K., me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër Urdhrin Përmbarimor P.nr.534/2022, të datës 19.09.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Besnik H. Aliu si i pasafatshme, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se debitori UNI Sh.P.K., me seli në Prishtinë, ka pranuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.534/2022, të datës 19.09.2022, me datën 21.09.2022 (ditë e Merkure) me çka vërtetohet

nga fletë dërgesa për dorëzim personal e Përmbauesit Privat, ndërsa debitori ka paraqitur prapësim me datë 30.09.2022 (ditë e Premte), fakt ky që vërtetohet nga vula tek përmbauesi privat.

Sipas nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbaimore përcaktohet se: "*Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbaues ose urdhrin përmbaues*", ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se: "*Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme*". Andaj duke marrë parasysh faktin se debitori Urdhrin Përmbaimit P.nr.534/2022, të datës 19.09.2022 e ka pranuar me datë 21.09.2022 (ditë e Mërkure) ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 22,09.2022 (ditë e Ejte) kalendari i muajit shtator-2022, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 28.09.2022 (ditë e mërkure). Nga kjo rezulton se debitori ka paraqitur ankesë 2 ditë me vonesë, pra jashtë afatit kohor

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 30.09.2022, e cila vërtetohet nga vula e përmbauesit privat, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me dy ditë vonesë. Pra, prapësimi i debitorit është ushtruar jashtë afatit të përcaktuar konform nenit 70 të LPP-së.

Gjykata e shkallës së dytë analizoi edhe pretendimet e debitorit në ankesë se prapësimin e ka dërguar përmes postës brenda afatit 28.09.2022 ku dhe ja ka bashkangjitur dëftesën e pranimit të dërgesës e lëshuar nga Posta e Kosovës në Prishtinë, e datës 28.09.2022 me numër serik të pranimit 20092022614044 e vulosur nga Posta e Kosovës, dhe si marrës në këtë Dëftesë rezulton të jetë Përmbauesi Privat Besnik H.Aliu . Mirëpo, Dhoma e Shkallës së Dytë, dëftesën e lartcekur e vlerësoj si të pabazuar kjo për faktin se nga flete-kthesa e Postës së Kosovës pjesë e shkresave të lëndës, nuk mund të vërtetohet se cili lloj i dokumentit është dërguar nga debitori, kjo sepse tek lloji i dërgesës evidentohet përshkrimi "Letrat" pa u specifikuar lloji i shkresës, andaj Gjykata nuk mund ta konsideroj si të rregullt pranimin e ankesës brenda afatit ligjor nga ana e debitorit përderisa nuk ka prova përmes të cilave vërtetohet se debitori ka dorëzuar mjetin juridik përmes postës së rregullt, prandaj nuk mund ta konsideroj si pranimit të rregullt.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendim.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Shk.II.nr.872/24 dt. 20.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri